



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, paragrafët 1, 2 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 33.2, shkronja a, dhe të nenit 34.1, shkronja d, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.10.2018, merr këtë

V E N D I M

- I. MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve: Remzi (Bajram) Aliu, Nuhi (Bajram) Aliu, Dinore (Ajvaz) Fazliu, Ruzhdi (Bajram) Aliu, Vehbi (Bajram) Aliu, Faton (Feti) Aliu, Agim (Liman) Ibrahimimi, Luta (Isuf) Beka, Zuka (Isuf) Beka, Xhavit (Pajazit) Bajrami, Naser (Halil) Beka, Skënder (Halil) Beka, Imer (Halil) Beka dhe Bekim (Halil) Beka.
- II.** Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 715-0, Zona Kadastrale (ZK) Matiçan, certifikata e pronësisë nr. P-71914050-00715-0, PSH, Kuvendi Komunal Prishtinë, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim është pjesa e parcelës kadastrale nr. 1605-6, ZK Matiçan, certifikata e pronësisë nr. P-71914050-01605-6, e destinuar për rrugë publike, e planifikuar sipas Planit rregullues “Mati 1”, në pronësi të Remzi (Bajram) Aliut, Nuhi (Bajram) Aliut, Dinore (Ajvaz) Fazliut, Ruzhdi (Bajram) Aliut, Vehbi (Bajram) Aliut, Faton (Feti) Aliut, Agim (Liman) Ibrahimit, Luta (Isuf) Bekës, Zuka (Isuf) Bekës Xhavit (Pajazit) Bajramit, Naser (Halil) Bekës, Skënder (Halil) Bekës, Imer (Halil) Bekës dhe Bekim (Halil) Bekës.
- III.** Këmbimi i pronave të paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues “Mati 1 “ dhe PZHU-së. Kjo i shërben shfrytëzimit për qëllime të interesit publik të Komunës dhe kapitali për financimin e këmbimit është siguruar.
- IV.** Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme komunale dhe vlerësimi i pronës private.
- V.** Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarëve të parcelës që do të shkëmbehet.

- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë e këtij vendimi janë shkresat e lëndës.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-0263713/18, më 01.11.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

